

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6829  
E shtunë, 18 shkurt 2023  
çmimi 0.40

## Kurti u mban ligjëratë ministrave



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 15-VJETORIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË

# ME PARAKALIMIN E USHTRISË DHE TË POLICISË SHËNOHET 15-VJETORI I SHTETËSISË



Institucionet e Kosovës dhe qytetarët me aktivitete të ndryshme e kanë shënuar 15-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një seancë solemne, në të cilën është theksuar se në këto 15 vjet Kosova

është zhvilluar e forcuar si shtet i ri, duke dëshmuar kulturë demokratike në organizimin e jetës politike dhe funksionimin e institucioneve. Për këtë datë të rëndësishme liderët shtetërorë dhe ata opozitarë kanë nderuar me

homazhe dëshmorët e rënë për liri, dhe në fund me duartrokitje të qytetarëve dhe nën tingujt e orkestrës së FSK-së, trupat e FSK-së dhe të Policisë së Kosovës kanë parakaluar në sheshet e kryeqytetit me të gjitha njësitet

## AKTUALE



OKB-ja KËRKON 1 MILIARD DOLLARË PËR T'JU NDIHMUAR TË PREKURVE NGA TËRMETI NË TURQI

F. 2

NË EVROPË BIE ÇMIMI I GAZIT

F. 6

KURTI DHE VUÇIQI TAKOHEN NË BRUKSEL MË 27 SHKURT

F. 7

## EKONOMI



VAZHDON RITJA E ÇMIMEVE TË KONSUMIT, INFLACIONI 12.1 PËR QIND

F. 8

QEVERIA NDAN MBI 10 MILIONË EURO PËR PAKON E RINGJALLJES EKONOMIKE

F. 8

## SPORT



ADEMI NË DITËN E PAVARËSISË: OBJEKTIVI YNË ËSHTË KUALIFIKIMI NË EVROPIAN

F. 10



## KOSOVA FESTON PA ÇLIRIMTARËT

LIDERI I PDK-së VIZITON FAMILJET E KRERËVE TË UÇK-SË TË CILËT NDODHEN NË HAGË

FAQE 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Mbi 300 000 pasagjerëve u anulohen fluturimet si pasojë e grevave në aeroportet e Gjermanisë

BERLIN, 17 SHKURT - Një grevë 24-orëshe në shtatë aeroporte gjermane ka ndikuar në fluturimet e gati 300 000 pasagjerëve, pasi sindikatat e punëtorëve janë duke kërkuar paga më të mëdha. "Terminalet janë të thata këtë mëngjes", ka thënë një zëdhënës i aeroportit në Hamburg. Sipas Asociacionit të Aeroporteve të Gjermanisë, rreth 2 340 fluturime janë anuluar në aeroportet e Bremenit, Dortmundit, Frankfurtit, Hamburgut, Hanoverit, Munihut dhe Shtutgartit. "Kur shikonim terminalet e aeroporteve këtë mëngjes, na janë kujtuar ditët më të rënda të pandemisë së koronavirusit", ka thënë udhëheqësi i Asociacionit të aeroporteve të Gjermanisë, Ralph Beisel për mediet gjermane. Sindikata gjermane e punëtorëve

Verdi ka paralajmëruar të mërkurën për protestë, pasi ka thënë se përpjekjet për të përmirësuar situatën për punëtorët e këtij sektori, kanë rezultuar me pak përparim. "Nëse nuk bëhet asgjë sa i përket pagesës, situata do të jetë sërish kaotike në verën e ardhshme", ka thënë zëvendëshefja e sindikatës Verdi, Christine Behle. "Kjo ka të bëjë me dërgimin e një mesazhi të fuqishëm". Greva është duke u mbajtur në ditën e hapjes së Konferencës së Sigurisë në Munihi. Ministrin të Jashtëm rumun, i cili kishte planifikuar të udhëtonte me një prej linjave që janë në grevë, tani do t'i duhet të shkojë në Austri dhe të bëjë një udhëtim mbi katër orë për të shkuar në Munihi, ka thënë një zyrtar i Ambasadës rumune në Gjermani.



## Udhëheqësia kineze shpall "fitore vendimtare" ndaj koronavirusit



PEKIN, 17 SHKURT - Udhëheqësia kineze ka shpallur "fitore vendimtare" në luftën kundër pandemisë së koronavirusit, pavarësisht akuzave se Pekini nuk është duke treguar numrin e saktë të viktimave me këtë virus. Prej muajit nëntor, përgjigjja e Kinës ndaj pandemisë ka përjetuar "tranzicion të butë për kohë të shkurtër", është thënë në deklaratën e lëshuar nga zyrtarë të një komiteti të lartë kinez që mbikëqyrte nga lideri i shtetit, Xi Jinping. Praktika e ka dëshmuar që Komiteti ka qenë i drejtë në vlerësimet ndaj pandemisë, është thënë në deklaratë. Më shumë se 200 milionë persona të infektuar me koronavirus kanë


kërkuar shërbime mjekësore dhe gati 800 000 raste serioze kanë marrë trajtim të duhur, është thënë në deklaratë. Mirëpo në këtë dokument nuk është përmendur numri i saktë i viktimave të shkaktuara nga vala e virusit që e ka prekur këtë vend në fund të vitit të kaluar. Në dhjetor të vitit 2022, Qeveria kineze pati braktisur strategjinë e zero rasteve me koronavirus, dhe ka lehtësuar kufizimet për luftim të pandemisë. Më pas ka pasur raportime se spitalet dhe krematoriumet nuk kanë pasur kapacitet për t'u përballur me numrin e madh të viktimave me këtë virus. Zyrtarisht janë raportuar 83.150 vdekje në spitale në periudhën

dhjetor-shkurt. Ka pasur edhe raportime se mjekëve u është thënë që të mos përmendin koronavirusin si shkak për vdekjen e një pacienti në certifikatat e vdekjes. Për koronavirusin e ri është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin si pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.7 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

## OKB-ja kërkon 1 miliard dollarë për t'iu ndihmuar të prekurve nga tërmeti në Turqi

NYU-JORK, 17 SHKURT - Kombet e Bashkuara janë duke u kërkuar vendeve anëtare që të kontribuojnë me 1 miliard dollarë për t'iu ndihmuar miliona njerëzve të prekur nga tërmeti që ka lënë të vdekur mbi 42 000 njerëz në Turqi dhe Siri. "Sot Kombet e Bashkuara janë duke bërë thirrje për ndihmë humanitare prej 1 miliard dollarësh për popullin e Turqisë, që është duke vuajtur nga tërmeti më shkatërrues që e ka goditur këtë shtet në shekullin e fundit", ka thënë sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres. Ai ka thënë se rreth 5.2 milionë njerëz kanë nevojë për këto fonde. "Turqia është shtëpia e numrit më të madh të refugjatëve në botë dhe ka treguar bujari të madhe me fqinjët e saj sirianë përgjatë

viteve", ka thënë Guterres, duke shtuar se tani është koha që bota ta mbështesë popullin e Turqisë ashtu siç ata kanë treguar solidaritet me vendet e tjera që kanë kërkuar ndihmë. "Njerëzit janë duke vuajtur dhe nuk kemi kohë për të humbur" ka thënë Guterres, duke i bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar të ndajë fonde për t'iu përgjigjur një prej "katastrofave më të mëdha natyrore të kohës sonë", ka theksuar Guterres. Tërmeti i parë, 7.7 shkallë i Rihterit, ka goditur Turqinë dhe Sirinë më 6 shkurt, i përcjellë disa orë më vonë nga një tërmet 7.6 shkallë. Më shumë se 42 000 njerëz kanë vdekur në të dyja vendet, derisa mijëra të tjerë vazhdojnë të jenë të zhdukur.





15 VJET SHTET, QYTETARËT E KOSOVËS SOLIDARIZOHEN ME LIDERËT E UÇK-së  
QË PO MBAHEN NË PARABURGIM NË HAGË

# KOSOVA FESTON PA ÇLIRIMTARËT

Kosova të premtën ka shënuar 15-vjetorin e pavarësisë, por pa strategjet e lirisë. Në nderim të 17 shkurtit, qytetarë të shumë janë mbledhur në një manifestim në Prishtinë me moton: “Festojmë me ju”, duke u solidarizuar me liderët e UÇK-së të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë. Në këtë manifestim është thënë se liderët e UÇK-së janë duke u mbajtur padrejtësisht në Hagë. Po në këtë manifestim është vlerësuar lart kontributi tyre për liri dhe pavarësi

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

**PRISHTINË, 17 SHKURT** - Me rastin e 17 shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Kosovës, qytetarë të shumë të mbledhur të premtën në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë janë solidarizuar me liderët e UÇK-së të cilët gjenden në paraburgim në Hagë.

Me moton “Festojmë me ju”, përpos qytetarëve, në këtë manifestim kanë marrë pjesë edhe bashkëluftëtarë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Hysni Gucatit, Nasim Haradinajt, Salih Mustafës dhe Pjetër Shalës.

Po në manifestimin “Festojmë me ju” kanë qenë të pranishëm edhe zyrtarë të lartë të PDK-së, Adem Grabovci, Ganimete Musliu, Mërgim Lushtaku, Hisen Berisha dhe Petrit Hajdari si dhe Fatmir Limaj me bashkëpunëtorë nga

Nisma Socialdemokrate.

Gjithashtu në këtë manifestim për nder të 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës kanë qenë të pranishëm edhe zyrtarë të PSD-së, Zgjim Hyseni e Frashër Krasniqi, Faton Klinaku nga OVLUÇK-ja dhe Rrahman Jasharaj nga SBASHK-u.

Edhe në këtë manifestim nuk kanë munguar brohoritjet “UÇK, UÇK”, “Thaçi, Thaçi”, “Krasniqi, Krasniqi”, “Veseli, Veseli”, “Selimi, Selimi”, “Liri për çlirimtarët”.

Në këtë manifestim, përpos këngëve kushtuar lirisë dhe pavarësisë, janë lëshuar fjalimet e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit dhe Fatmir Sejdiut të mbajtura në Kuvendin e Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008, kur Kosova ishte shpallur shtet sovran.

I vetmi që ka mbajtur një fjalë rasti në manifestimin “Festojmë me ju” ka qenë kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i



cili ka qenë një ndër eprorët më të lartë të UÇK-së.

Limaj ka thënë se liderët e UÇK-së janë duke u mbajtur padrejtësisht në Hagë.

Ai thënë se ky manifestim është organizuar për t'i nderuar shpallësit e Pavarësisë së Kosovës. “Sot të gjithë jemi mbledhur këtu për të nderuar dhe për të shprehur mirënjohje për shpallësit e Pavarësisë së Kosovës. Ne sot këtu bashkë, e kudo ku ka shqiptarë, festojmë me ata që e çliruan, ndërtuan dhe e shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe të lirë. Festojmë me ju president i

Republikës, Hashim Thaçi, kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi dhe kryetar i Kuvendit, Kadri Veseli. Festojmë me ju publikuesi i parë i UÇK-së dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi. Festojmë me ju të nderuar bashkëluftëtarë, ju që në vijat e frontit nuk kursyet asgjë për lirinë e Kosovës, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa, Pjetër Shala dhe Hysni Gucati. Të nderuar miq, sot në krye me komandantin legjendar i nderojmë të gjithë dëshmorët e kombit. Çdo 17 shkurt është moment i nderimit”, ka thënë Limaj, duke shtuar se është koha

që të tregohet se kush e bëri historinë dhe shtetin e Kosovës. “Tani është koha që ju të flisni. Është koha që edhe një herë t’ua kujtoni atyre të cilët e mohojnë historinë dhe lirinë e Kosovës. Tregojuni se kush janë ata që e shpallën dhe ndërtuan shtetin e Kosovës”, ka thënë Limaj.

Kujtojmë se liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Gjykimi ndaj tyre pritet të fillojë në muajin prill të këtij viti.





REPUBLIKA E KOSOVËS KA SHËNUAR 15-VJETORIN E SHPALLJES SË PAVARËSISË

## Me parakalimin e Ushtrisë dhe të Policisë shënohet 15-vjetori i shtetësisë

Institucionet e Kosovës dhe qytetarët me aktivitete të ndryshme e kanë shënuar 15-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një seancë solemne, në të cilën është theksuar se në këto 15 vjet Kosova është zhvilluar e forcuar si shtet i ri, duke dëshmuar kulturë demokratike në organizimin e jetës politike dhe funksionimin e institucioneve. Për këtë datë të rëndësishme liderët shtetërorë dhe ata opozitarë kanë nderuar me homazhe dëshmorët e rënë për liri, dhe në fund me duartrokitje të qytetarëve dhe nën tingujt e orkestrës së FSK-së, trupat e FSK-së dhe të Policisë së Kosovës kanë parakaluar në sheshet e kryeqytetit me të gjitha njësitet

organizimin e jetës politike dhe funksionimin e institucioneve”, kështu ka thënë presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në seancën solemne me rastin e 15-vjetorit të pavarësisë së Kosovës. Sipas saj, Kosova ka ndërtuar e zhvilluar kapacitetet e saj shtetërore dhe ka krijuar bazë solide për funksionim të mëtijshëm. “Institucionet tona

po forcohen dita-ditës. Kjo është e arritur e madhe e qytetarëve tanë”, ka thënë Osmani para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ajo ka thënë se sfidat, sigurisht, kanë qenë të pranishme, por janë tejkaluar me urti, duke qenë të përkushtuar për shtet të mirëfilltë e partneritet të qëndrueshëm me aleatët tanë.

“Këto sfida ndonjëherë na kanë bërë të përplasemi së brendshmi, ngaqë pikëpamjet tona kanë qenë të ndryshme, sikur është e nënkuptueshme për shoqëritë demokratike. Por, gjithsesi, na kanë bërë edhe më të fortë. Kanë dëshmuar aftësinë tonë për të qenë të qëndrueshëm karshi tyre e për ta zhvilluar më tej jetën tonë demokratike”,

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 17 SHKURT** - Për nder të 15-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj dhe komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, kanë marrë pjesë të premtën në ceremoninë e ngritjes solemne të flamurit të Republikës, duke shënuar kështu edhe fillimin e aktiviteteve për këtë ditë, më pas liderët shtetërorë kanë bërë homazhe te Memoriali i të

Pagjeturve para Kuvendit të Kosovës.

Aktivitetin për nder të 15-vjetorit të pavarësisë e vazhduan me homazhe dhe vendosje të luleve te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te varri i veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Adem Demaçi.

Liderët shtetërorë kanë bërë homazhe edhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe pastaj kanë marrë pjesë edhe në parakalimin e trupave të FSK-së dhe Policisë së Kosovës në tri sheshet e Prishtinës. “Në këto 15 vjet Kosova është zhvilluar e forcuar si shtet i ri, duke dëshmuar kulturë demokratike në



është shprehur ajo, duke shtuar se këto sfida janë të pranishme edhe sot, kur Kosova, falë përcaktimit të saj të hershëm, po përipiqet që ta fuqizojë edhe më tej pozitën e saj ndërkombëtare drejt integritetit të vendit në strukturat euroatlantike. “Sigurisht, Kosova nuk mund të jetë ishull i izoluar karshi sfidave e kërcënimeve që e kanë sfiduar gjithë kontinentin tonë dhe botën demokratike. Por, ajo nuk mund t’i injorojë edhe kërcënimet e sigurisë ndaj saj, të cilat vijnë si rrjedhojë e përpjekjeve për ta minuar shtetësinë tonë”, ka deklaruar Osmani.

Ajo ka thënë se sot kujtojmë sakrificën e pashembullt dhe qëndresën e pareshtur të brezave, e cila i parapriu jetësimit të ëndrrës për liri e demokraci. “Ta kujtojmë prijatarin e shtetësisë sonë, presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën, i cili e siguroi respektin e gjithë botës demokratike; t’i kujtojmë bijtë e bijat tona, të cilët, të rreshtuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, sakrifkuan jetën e tyre në

ka theksuar se akti i deklarimit të Pavarësisë së Kosovës dhe shpalljes së saj shtet, shënon hapjen e një kapitulli të pakthyeshëm në historinë moderne të Kosovës. “Kumti i këtij kapitulli është vullneti politik i popullit të saj, që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe sovran, demokratik dhe i pandashëm. Ky kapitull duhet të mbetet i tillë, duke u mbrojtur politikisht dhe përforcuar në vazhdimësi, nga të gjithë, në secilin rast, para çdo sfide!”, ka thënë Kurti në fjalimin e tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ai ka thënë se shpallja e pavarësisë së Kosovës këtu e 15 vjet më parë ishte rezultat i shumë përpjekjeve dhe sakrificave të skajshme të popullit tonë shqiptar si dhe i ndihmës e përkrahjes aq të nevojshme të partnerëve dhe aleatëve tanë ndërkombëtarë. “Krijimi i Republikës së Kosovës erdhi pas 666 shekujsh të kaluara gjithsej nëpër burgje nga mijëra të burgosur politikë, siç erdhi edhe nga gjenerata të tëra mësimdhënësish që edukuan dhe shkolluan breza të tërë në



që me luftën e tyre të drejtë arritën t’i përfshijnë edhe aleatët ndërkombëtarë që më 1999 na ndihmuan të çlirohemi nga Serbia pushtuese”, ka thënë

## Bideni uron Kosovën për 15-vjetorin e pavarësisë

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, ka uruar Kosovën për 15-vjetorin e shpalljes së pavarësisë, duke u zotuar se Uashingtoni do ta vazhdojë mbështetjen për Prishtinën. Në letrën dërguar presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, Bideni ka shprehur mbështetjen e tij për dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. “ShBA-ja do të vazhdojë ta mbështesë

integrimin e Kosovës në institucionet euroatlantike dhe dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja për normalizimin e raporteve me Serbinë. Ne mirëpresim pranimin e propozimit të BE-së për normalizim, me synimin përfundimtar të njohjes reciproke, që do të ndihmonte të arrihej një e ardhme më paqësore dhe prosperuese për popullin e Kosovës dhe Serbisë”, thuhet në letrën e Bidenit.



mbrojtje të vendit, komandantin historik të kësaj ushtrie, Adem Jasharin, i cili i priu rezistencës për liri; t’i kujtojmë përfaqësuesit e institucioneve të pavarura të Kosovës, të cilët përgjatë këtyre 15 vjetëve kontribuan në ndërtimin e jetës demokratike në vend, por edhe në paqen e përgjithshme”, është shprehur Osmani.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti

frymë patriotike dhe atdhedashurie. Republika e Kosovës erdhi nga gjaku i dëshmorëve dhe i martirëve të rënë dhe i secilës jetë të dhënë për lirinë e këtij vendi, siç erdhi edhe nga kontributi i atyre që i drejtuan dhe i zhvilluan proceset politike shtetndërtuese deri në këtë ditë. Republika jonë erdhi nga lufta e lavdishme e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Kurti.

Për 15-vjetorin e pavarësisë fjalim ka mbajtur edhe presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, i cili ka thënë se Shqipëria është pranë Kosovës për anëtarësimin e saj në NATO dhe OKB dhe në të gjitha organizatat e tjera ndërkombëtare.

Kurse kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, derisa bëri homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, tha se

sakrificën dhe flijimin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij do ta kujtojnë gjithnjë. Ai ka theksuar se liria dhe pavarësia kanë qenë të pamundshme pa luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e momenti më i lavdishëm i luftës çlirimtare ka qenë lufta e Jasharëve kundër Serbisë për çlirim dhe flijimi i gjithë familjes. “Sakrifica e Jasharëve e ka ngritur në një dimension tjetër edhe kombin shqiptar, por në anën tjetër edhe e ka zgjuar botën, e ka tronditur ndërgjegjen ndërkombëtare dhe prej atij momenti nuk ka pasur askush dyshim që liria për popullin shqiptar është e pashmangshme”, ka deklaruar kryetari Konjufca.

Kryetari i Partisë Demokratike të

Kosovës, Memli Krasniqi, në fjalën e tij para deputetëve ka theksuar se historia e Kosovës moderne është e lidhur me emrat e çlirimtarëve që gjenden në Hagë për ta mbrojtur të vërtetën e luftës së UÇK-së, e veçmas me ish-kryeministrin dhe ish-presidentin Hashim Thaçi. “Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi e bashkëlufëtaretë tjerë, sot janë larg nesh, duke e zhvilluar betejën e fundit për të vërtetën e luftës sonë për liri. Do të duhej të ishin në këtë sallë bashkë me ne, në një rast solemn si ky që përkujton një ngjarje kaq madhështore, protagonistë të së cilës ishin pikërisht ata vetë. E ndonëse ata nuk janë me ne fizikisht, vazhdojnë të mbesin në zemrat e qytetarëve të Kosovës”, ka thënë Krasniqi.

Ndërkaq lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, në fjalimin e tij në seancën solemnë, ka numëruar disa momente historike, përfshirë rrugëtimin ditor të Ibrahim Rugovës nga udhëkryqi i Velanisë, të cilin e ka quajtur si “ati themeltar të shtetit të Kosovës”.

E kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe në Kompleksin Meomorail në Prekaz, ku ka theksuar se nderimi është i përhershëm për Jasharët dhe kryekomandantin Adem Jashari, të cilët ndryshuan rrjedhën e historisë sonë të re.



# Lideri i PDK-së viziton familjet e krerëve të UÇK-së të cilët ndodhen në Hagë

“Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, duke qenë pjesë e celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, finalizuan përpjekjet shekullore të popullit të Kosovës për liri, si dhe pas çlirimit vazhduan punën për ta jetësuar ëndrrën tonë për shtet të pavarur e sovran, demokratik e të zhvilluar”, ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, me rastin e vizitës që ua bëri të premtën familjeve të krerëve të UÇK-së të cilët ndodhen në paraburgim nga Gjykata Speciale në Hagë

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka uruar përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës me fotografi nga vizitat që ua ka bërë familjarëve të krerëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët aktualisht ndodhen në paraburgim nga Gjykata Speciale në Hagë. “Nder e krenari që shënimin e datës historike të 17 shkurtit ta filloj me vizita te



familjet e heronjve të luftës dhe të paqes, të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, duke qenë pjesë e celulave të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, finalizuan përpjekjet shekullore të popullit të Kosovës për liri, si dhe pas çlirimit vazhduan punën për ta jetësuar ëndrrën tonë për shtet të pavarur e sovran, demokratik e të

zhvilluar”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”.

Ai ka thënë se kontributi i Hashimit, Kadriut, Jakupit dhe Rexhepit nuk u kufizua në një etapë të vetme historike. “Misioni i tyre për t’i dalë zot Kosovës ishte dhe mbetet i përhershëm. Ndonëse sot çlirimtarët janë larg familjeve të tyre dhe larg nesh në misionin e tyre për ta dëshmuar pastërtinë e luftës së UÇK-së, me

mendje dhe me zemër ata i kemi përherë pranë. Jam i lumtur që një pjesë të rrugëtimit tim politik, pata fatin ta zhvilloj përkrah këtyre personaliteteve. Mirënjohje e respekt maksimal për punën e palodhur dhe angazhimin e pandalur të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe të gjithë luftëtarëve të UÇK-së për Kosovën”, ka theksuar Krasniqi.



## Gjykata Speciale ia vazhdon Thaçit paraburgimin në Ditën e Pavarësisë

Hagë, 17 shkurt - Në ditën e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ish-kreut politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Gjykata Speciale ia ka

vazhduar paraburgimin. Vendimi është marrë të premtën nga trupi gjyqësor, kur Kosova festonte 15-vjetorin e shtetësisë. Në dokumentin që

ka parë “lajmi.net”, i cili mban nënshkrimin e kryetarit të trupit gjyqësor, Charles Smith, ish-gjyqtar në EULEX, i përfolur për skandale nga ish-kolegët e tij,

është thënë se mbrojtja mund t’i dorëzojë ankesat e saj me parashtrësia deri më 3 mars, ndërsa prokuroria ka kohë deri më 27 mars që të përgjigjet.



## Në Evropë bie çmimi i gazit

OSLO, 17 SHKURT - Çmimi i gazit natyror në Evropë më 17 shkurt ka rënë nën 50 euro për herë të parë në pothuajse një vit e gjysmë. Çmimi i gazit standard në Dutch TTF ra në 48.775 euro për litër. Ky nivel i çmimit për herë të fundit kishte qenë në gusht të vitit 2021, që i bie se

është pothuajse shtatë herë më i ulët sesa çmimet e larta për gaz që ishin pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës pothuajse një vit më parë. “Çmimet e gazit evropian kanë rënë për 50 për qind që nga nëntori i vitit të kaluar falë motit të nxehtë... konkurrencës me

Kinën kur në këtë shtet ishte ende në fuqi strategjia Zero-Covid”, tha analisti nga “UniCredit”, Edoardo Campenella. Kina hoqi kufizimet ndaj pandemisë së koronavirusit në dhjetorin e vitit të kaluar, por ky shtet ende nuk ka rritur kërkesat

e saj për gaz. Pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, shtetet perëndimore janë detyruar të furnizohen me gaz nga shtete të tjera, jo nga Rusia, që është një prodhuese e madhe e këtij produkti. Që atëherë Norvegjia është bërë furnizuesja kryesore e Evropës



me gaz. Konflikti në Ukrainë ka shkaktuar trazira në ekonominë globale, duke rritur çmimet e energjisë dhe inflacionin.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI MBLEDH KABINETIN QEVERTAR

# Kurti u mban ligjëratë ministrave

Për 15-vjetorin e shtetësisë së Kosovës, kryeministri Albin Kurti ka thirrur një mbledhje të qeverisë. Fjalimi i tij ishte më shumë ligjëratë për ministrat e tij se si duhet të sillen ndaj shtetit dhe si nuk duhet ta harrojnë historinë nëpër të cilën ka kaluar populli ynë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 17 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka uruar qytetarët në 15-vjetorin e shtetësisë, duke thënë se shteti i Kosovës është shembull i mirë i demokracisë “në këtë rajon problematik siç është Ballkani”. Ai i ka bërë këto deklarata në një mbledhje festive të qeverisë për 15-vjetorin e shtetësisë së Kosovës. “Mirëmëngjesi e mirëserdhët në këtë mbledhje të qeverisë e cila është e veçantë, sepse shënon hapjen e kësaj dite festive. Simbolikisht kemi zgjedhur të hapim këtë ditë jo me ceremoni, por me mbledhje, sepse dëshirojmë ta përcjellim mesazhin se puna e festa për Republikën tonë duhet të shkojnë gjithmonë bashkë. Pavarësia jonë u arrit përmes luftës dhe sakrificës, por pavarësia jonë do të rritet vetëm përmes punës. Jo përmes rrugëve të shkurtra që premtohen nga njerëz joseriozë, por vetëm përmes punës dhe sakrificës e cila i karakterizon njerëzit e mirë të Kosovës, gratë e burrat që punojnë përditë për veten e tyre, për familjet e tyre, për shoqërinë tonë, për ekonominë tonë. Ata punojnë këtu, por shpesh punojnë edhe jashtë vendit, ku kushtet janë më të mira dhe shpërblehen për punën e tyre. E në këtë festë të 15-vjetorit të Pavarësisë duhet t’ia përkujtojmë



vetes e njëri-tjetrit se detyra jonë kryesore është që, kur të vijë njëzetvjetori, të jenë shtuar e shumëfishuar arsyet që të rejtat e të rinjtë tanë të mund të zgjedhin edhe Kosovën për një të ardhme profesionale të plotë e për një jetë të mirë”, ka thënë Kurti para ministrave të tij. Ai ka thënë se në këtë festë të pavarësisë nuk i takon të jetë i ashpër me ministra. “Ka boll ditë të tjera të vitit kur do të mund ta zhvillojmë aktivitetin tonë të përditshëm që përfshin edhe punën edhe nxitjen, edhe kritikën edhe vetëkritikën, natyrisht edhe

mbajtjen e përgjegjësisë, sepse të qenit anëtar i një qeverie do të thotë, mbi të gjitha, marrje përsipër e përgjegjësisë. Meritat, siç e thashë më parë, në radhë të parë u përkasin qytetarëve tanë, punëtorëve, studentëve, biznesmenëve, njerëzve të zanateve të ndryshme, të kulturës, të sportit, të cilët me kontributin e tyre të përditshëm e bëjnë Kosovën kjo që është, një vend në përmirësim të vazhdueshëm”, është shprehur Kurti. Ai ka theksuar se si kabinet qeveritar kanë dy përgjegjësi. “E

para, të kemi parasysh gjithnjë trashëgiminë tonë, amanetet e gjeneratave që kanë dhënë gjakun e djersën për lirinë e Kosovës edhe pse nuk kanë arritur ta shijojnë atë. Çdo ditë e jona, të nderuar ministra, zëvendëskryeministra, duhet të nisë me përkujtimin e këtij amaneti. Ky amanet është i paneglizhueshëm, sepse nuk erdhëm ne këtu nga zeroja. Kosova nuk është produkt i rastësisë, por i historisë së vet. Shekuj dhimbjesh, që sot të kemi këtë gëzim. E dyta, duhet të kemi gjithnjë parasysh të rinjtë, fëmijët

dhe ata të cilët nuk kanë lindur ende e të cilëve ne duhet t’u lëmë patjetër një Kosovë më të mirë sesa ajo që e kemi gjetur. Mjedisin duhet t’ua lëmë më të pastër e më të gjelbër nga ai që gjetëm, ekonominë më të pasur e më të drejtë, drejtësinë më funksionale, infrastrukturën më moderne, shëndetësinë më të pajisur dhe arsimin më të fortë. Një Kosovë ku udhëheq ligji, e jo njeriu, një Kosovë me rend për qytetarët e me ndëshkim për kriminelët. Këto ishin ambiciet tona në fillim, por këto duhet të jenë ambiciet tona përditë”, ka thënë Kurti.

## Kurti dhe Vuçiqi takohen në Bruksel më 27 shkurt

PRISHTINË, 17 SHKURT - Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, ka thirrur për 27 shkurt takimin në nivel të lartë në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiqi. Sipas burimeve, Kurti dhe Vuçiqi e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në raundin e ri të dialogut dhe temë e takimit pritet të jetë propozimi evropian për normalizimin e plotë të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit të organizuar nga Borrelli, i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, do të ketë takime të veçanta me ta. Kurti dhe Vuçiqi nuk kanë zhvilluar takim në kuadër të dialogut të Brukselit që nga



nëntori i vitit 2022.

Vitin e kaluar, Kosovës dhe

Serbisë iu dorëzua propozimi evropian, siç njihet edhe si

propozimi franko-gjerman.

Palët kanë konfirmuar se e

pranojnë këtë dokument, por ai nuk është bërë publik.

Megjithatë, në një draft që e ka parë “Radio Evropa e Lirë”, aty nuk përmendet në mënyrë specifike njohja, por parashihen të drejta të barabarta për Kosovën dhe Serbinë, respektim i integritetit territorial, paprekshmëri e kufijve, njohje e simboleve shtetërore dhe një aranzhim i veçantë për komunitetin serb në Kosovë.

Kosova dhe Serbia i kanë nisur negociatat e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian më 2011.

Palët kanë synime të ndryshme sa i përket marrëveshjes finale që synohet të arrihet në këtë proces. Kosova insiston në njohje reciproke, ndërkaq Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

## Qeveria ndan mbi 10 milionë euro për Pakon e Ringjalljes Ekonomike

PRISHTINË, 17 SHKURT - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e 128-të, ka miratuar vendimin për ndarjen e 10,300,000.00 eurove për zbatimin e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Sipas njoftimit për medie, thuhet se, përveç këtij vendimi, qeveria ka miratuar edhe disa vendime të tjera, duke përfshirë vendimin me të cilin jep mendim lidhur me Nismën legislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe

Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158. “Qeveria vlerëson nismën në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë mbështet nismën e propozuar dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vlerësuar se kjo nismë nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës”, thuhet në njoftim.

Në mbledhjen e qeverisë u miratua edhe vendimi për themelimin e Komisionit për

Shtesën e Kushteve Specifike të Punës, vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 29/112 të datës 13 dhjetor 2022 për miratimin e Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, si dhe vendimin për miratimin e ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë për të punësuarit në sektorin publik, sipas Ligjit nr. 08/L-196 për



Pagat në Sektorin Publik për të cilët është i nevojshëm procesi i klasifikimit të vendeve të punës.

# Vazhdon rritja e çmimeve të konsumit, inflacioni 12.1 për qind

**EPOKA E RE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHKURT - Çmimet në vendin tonë janë rritur edhe në muajin janar krahasuar me muajin dhjetor të vitit që lamë pas. Sipas raportit të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.9 për qind në muajin janar të këtij viti.

Ndërkaq norma vjetore e inflacionit e matur në muajin janar të këtij viti me muajin janarin e vitit 2022 ishte 12.1 për qind. “Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0.9-përqindësh në muajin janar 2023 krahasuar me muajin dhjetor 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: perime 10.4 për qind; energji elektrike 3.1 për qind; duhan 2.6 për qind; mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake 2.2 për qind; pemë 1.9 për qind; shërbime financiare 1.8 për qind; pajisje shtëpiake 1.8 për qind; shërbime rekreative dhe kulturore 1.6 për qind; shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit 1.6 për qind; qumësht, djathë dhe vezë 1.5



për qind; pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal (1.5 për qind); bukë dhe drithëra (1.2 për qind); prodhime ushqimore (0.8 për qind). Po ashtu për blerje të automjeteve 0.8 për qind; shërbime ambulatorie 0.6 për qind; mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit (0.2 për qind); kafe, çaj dhe kakao 0.1 për qind, me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.9 për qind në IHÇK”, thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, inflacioni vjetor i matur në muajin janar të këtij viti me muajin janar të vitit të kaluar është 12.1 për qind. “Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 12.1 për qind në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: vajra dhe yndyra 26.0 për qind; bukë dhe drithëra 21.2 për qind; mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të

ekonomisë shtëpiake 20.5 për qind; mish 18.9 për qind; sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira 18.9 për qind; prodhime ushqimore 16.5 për qind; mirëmbajtje dhe rregullim i vendbanimit 16.3 për qind; energji elektrike 15.4 për qind; karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal 13.3 për qind; perime 10.8 për qind; vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht 10.7 për qind; mirëmbajtje dhe riparim i pajisjeve personale të transportit 10.6 për qind; peshk

10.4 për qind; qumësht, djathë dhe vezë 10.4 për qind; pjesë këmbimi dhe pajisje shtesë për pajisjet e transportit personal 9.9 për qind; mbrojtje sociale 9.5 për qind; pije alkoolike 9.4 për qind; kafe, çaj dhe kakao 9.0 për qind; pemë 8.8 për qind”, ka njoftuar ASK-ja. Ligji për vendosjen e çmimeve tavan për produktet bazë është miratuar në nëntor të vitit 2022 në Kuvendin e Kosovës, por nuk është duke u zbatuar për shkak se opozita e ka dërguar në Kushtetuese për interpretim.

## “McDonald’s” nxjerr në treg ushqimin vegjetarian “McNuggets”

BERLIN, 17 SHKURT - “McDonald’s” do ta prezantojë javën e ardhshme ushqimin me bazë bimore të njohur si “McNuggets”, i cili fillimisht synon tregun gjerman. “McPlant Nuggets”, i cili përbëhet nga bizele, misër dhe grurë, është një tjetër produkt që “McDonald’s” ka zhvilluar me “Beyond Meat”. I pari ishte

hamburgeri “McPlant”, i cili është në treg që nga viti 2021. “McDonald’s” deklaroi se ka testuar produktin në nëntë restorante në zonën e Stuttgartit dhe se synon ta shesë atë në më shumë se 1 400 restorante në shtetin gjerman duke filluar nga java e ardhshme. Sa iu përket tregjeve të tjera, kompania

thotë se do të varet nga kërkesa e klientëve, raporton AP. Evropianët në përgjithësi janë më të prirë drejt versioneve vegjetariane të produkteve të “McDonald’s” sesa amerikanët. “Burger McPlant” aktualisht shërbehet në Mbretërinë e Bashkuar, Irlandë, Austri dhe Holandë.





# Tre të pavërteta të mëdha, që duhet të mos ua themi më fëmijëve



Sipas psikologut të shquar social Jonathan Haidt, aktualisht janë tre të pavërteta të mëdha që ne u mësojmë fëmijëve tanë: (1) "Ajo që nuk të vret të bën më të dobët"; (2) "Gjithmonë besoj ndjenjave të tua"; dhe (3) "Jeta është një betejë midis njerëzve të mirë dhe njerëzve të këqij." Përforcimi i këtyre dogmave përmes prindërimit dhe edukimit i lë brezat e ardhshëm të papërgatitur për të lulëzuar në një botë komplekse dhe të ndërlikur. Sipas Haidt, realiteti është më shumë ngjyrësh

Në vitin 2018, psikologu social i famshëm, Jonathan Haidt, profesori Thomas Cooley i Udhëheqjes Etike në Shkollën e Biznesit Stern të Universitetit të Nju Jorkut dhe gazetari Greg Lukianoff, presidenti i Fondacionit për të Drejtat Individuale dhe Shprehjen, publikuan librin e tyre "The Coddling of the American Mind". Në të, ata argumentojnë bindshëm se brezi aktual i prindërve dhe edukatorëve po i çon fëmijët në rrugë të gabuar. Duke përjetësuar tre të pavërteta të mëdha – (1) "Ajo që nuk të vret të bën më të dobët"; (2) "Gjithmonë besoj ndjenjave të tua"; dhe (3) "Jeta është një betejë midis njerëzve të mirë dhe njerëzve të këqij" – të rriturit po i zhgënjajnë të rinjtë, duke i lënë fëmijët të papërgatitur për t'u përballur me një botë komplekse.

## E pavërteta Nr. 1: Ajo që nuk të vret të bën më të dobët

E pavërteta e parë, "Ajo që nuk të vret të bën më të dobët", duket se është një përmbysje e plotë e një fjale të urtë me fuqizuese: "Ajo që nuk të vret të bën më të fortë". Prindërit dhe edukatorët sot po shqetësohen gjithnjë e më shumë se mos shkaktojnë çfarëdolloj "traume" te fëmijët, të merakosur se kjo mund të lërë plagë mendore jetëgjata. Parandalimi dhe prindërimi tejet protektiv janë nënprodukte të kësaj dëshire për të mbrojtur fëmijët nga çdo burim i mundshëm dëmtimi, qoftë fizik apo emocional. Por kjo tendencë në rritje shkon kundër dekadave kërkimesh që tregojnë se të rinjtë prirën të jenë jashtëzakonisht elastikë ndaj

përvojave negative. Në vend që të jenë të brishtë, ato janë "anti-të brishtë", thotë Haidt. Ashtu si kockat dhe muskujt duhet të përdoren dhe të tendosen për të qëndruar të forta, dhe sistemi imunitar duhet të ekspozohet ndaj patogjenëve për të qëndruar në formë të mirë, psikika e fëmijëve duhet të sfidohet për t'i mbajtur ata të ekuilibruar dhe të shëndetshëm. "Duke i mbrojtur me tepri fëmijët tanë, ne po i vendosim ata në pozicion të dobët, që të dëmtohen më kollaj, të dekurajohen më lehtë", thotë Haidt për Big Think. "Kur i mbrojmë fëmijët nga pakënaqësia, nga konfliktet, nga fyerjet, nga ngacmimet, nga përjashtimi, ne jemi duke parandaluar psikologjinë e tyre sociale, jemi duke parandaluar aftësitë e tyre sociale, jemi duke penguar zhvillimin e forcës së tyre."

## E pavërteta Nr. 2: Gjithmonë besoj ndjenjave të tua

Një e pavërtetë e dytë që Haidt dhe Lukianoff e shpjeguan është "beso gjithmonë ndjenjat e tua". "Ajo që kemi filluar të shohim në kampus është se studentët inkurajohen të ndjekin ndjenjat e tyre; nëse ndihen të ofenduar nga diçka atëherë ata ndihen të sulmuar. Ata nuk duhet t'i vënë në dyshim ato ndjenja, "tha Haidt.

Frazat fantastike si "e vërteta personale" dhe "përvoja e jetuar" tani përdoren shumë shpesh për të vendosur ndjenjat në të njëjtin skalion si faktet. Por ato nuk janë aspak në të njëjtin nivel. Ndjenjat janë subjekt i qindra paragjykimeve njohëse që lodhin të menduarit e njerëzve. Faktet, nga ana tjetër, janë fakte.

"Ne duhet t'i mësojmë të rinjtë në të gjitha fazat që të vënë në dyshim interpretimet e tyre të menjëhershme, të kërkojnë prova dhe të përmirësojnë mënyrën se si e interpretojnë botën," tha Haidt.

## E pavërteta Nr. 3: Jeta është një betejë midis njerëzve të mirë dhe njerëzve të këqij


E pavërteta e fundit e madhe, "më e keqja, më e rrezikshmja dhe më e errëta nga të gjitha", sipas Haidt, është se jeta është një betejë midis njerëzve të mirë dhe njerëzve të këqij. Kjo e pavërtetë ushqehet me ndjeshmërinë e rrënjësor të njerëzimit ndaj tribalizmit. "Ne kemi evoluar në shoqëri të vogla që ishin të kapura në luftë me shoqëri të tjera të vogla," shpjegoi Haidt. "Natyra njerëzore është me të vërtetë e përshtatur mirë për konfliktin ndër-grupor, për luftën fisnore." Pra, kur edukatorët dhe studentët i filtrojnë njerëzit në identitetet e tyre të ndryshme

dhe ngrënë idenë se veprimet dhe pikëpamjet e tyre përcaktohen pothuajse tërësisht nga ato identitete, ata po përforcojnë idenë se njerëzit janë automatikë bardh e zi dhe jo individë kompleksë, në nuanca të ndryshme të grisë.

"Në disa kampuse të kolegjeve dhe në disa shkolla të mesme ne shohim forma edukimi, forma trajnimit që i mësojnë studentët të bëjnë gjithnjë e më shumë dallime, të shohin gjithnjë e më shumë dimensione binare midis njerëzve", shtoi Haidt. "Sa më shumë t'i inkurajojmë njerëzit që t'i shohin njerëzit rreth tyre si të mirë kundër të këqijve, aq më i vështirë do të jetë krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës dhe të larmishëm.

## Ja përfundimi i Haidt:

"Fëmijët janë anti – të brishtë, ne të gjithë jemi të prirur ndaj arsytimit të motivuar dhe paragjykimeve konfirmuese, dhe të gjithë jemi të prirur ndaj të menduarit bardh e zi. Nëse duam të rrisim një brez fëmijësh që mund të përballen dhe pranojnë diversitetet të të gjitha llojeve, të cilët mund të ecin para në një botë që është fizikisht mjaft e sigurt dhe megjithatë plot me përmbajtje ataku, ne duhet t'i bëjmë praktikën tona edukative në përputhje me këto tre parime psikologjike". / **Big Think – Bota.al**



Veton Zymberi, redaktor i sportit

## Ademi në ditën e Pavarësisë: Objektivi ynë është kualifikimi në Evropian

PRISHTINË, 17 SHKURT - 17 Shkurti është dita e Pavarësisë së Kosovës, një ditë festë për shqiptarët kudo që janë. Në këtë ditë të rëndësishme kryetari i Federatës të Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, i ka uruar të gjithë bashkëkombësit, duke i nderuar të gjithë ata që kontribuuan deri në arritjen e shpalljes së pavarësisë. Në këtë përvjetor i pari i FFK-së ka theksuar se synojnë ta realizojnë ëndrrën e kamotshme, kualifikimin në Evropian. “Shënojmë me mburrje e krenari 15-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së vendit tonë. Shumë dekada sakrificë e rezistencë, shumë angazhim, kontribut e gjak i derdhur për lirinë e atdheut dhe pavarësinë e tij. Në këtë përvjetor dua t’i uroj të gjithë bashkëkombësit kudo që jetojnë e veprojnë, me shpresë e besim se bashkërisht, me punë e përkushtim, do t’i realizojmë aspiratat tona si popull. E një nga objektivat në këtë përvjetor të pavarësisë është jetësimi i ëndrrës së kamotshme, kualifikimit në Kampionatin Evropian”, ka



thënë Ademi. “Futboli që nga ditët e para ka qenë shtyllë e rëndësishme e shtetësisë dhe ka promovuar vlerat e vendit tonë. Vitet e fundit kemi bërë përparim të madh në të gjitha

aspektet. Këtë e dëshmuar edhe klubet tona me paraqitjet e shkëlqyeshme në garat evropiane në edicionin e kaluar. Tani jemi mobilizuar dhe po punojmë plot vullnet për ciklin

kualifikues që nis në mars, me shpresa të mëdha se kualiteti dhe dëshira e madhe e djemve tanë dardanë kësaj radhe do të shpaguehet me kualifikim në ‘Euro 2024’. Nderim të

përvjetshëm të gjithë heronjve, dëshmorëve, ushtarëve çlirimtarë e veprimtarëve të çështjes kombëtare. Urime 15 vjet shtet! Zoti e bekoftë Kosovën!”, ka shtuar Ademi.

## Besa fiton Superkupën për meshkuj, Istogu për femra



ISTOG, 17 SHKURT - Besa Famgas e ka fituar Superkupën e Kosovës në hendboll. Besa e mposhti Kastriotin e Ferizajt me rezultatin 36:29. Dallimi në rezultat u bë në pjesën e dytë, në të cilën skuadra pejane dominoi plotësisht. Besa në edicionin e kaluar kishte fituar titullin e kampionit dhe Kupën e Kosovës. Tani ka fituar trofeun e parë të edicionit 2022/2023. Trofeun e Superkupës, kapitenit të Besa Famgas, Egzon Gjukës, ia dorëzoi presidenti i FHK-së, Eugen

Saraçini. Superkupa po zhvillohet në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Istogu e ka fituar Superkupën e Kosovës në hendboll (femrat). Të enjten mbrëma skuadra istogase e mposhti Ferizajn me rezultat 33:17. Ndeshja për Superkupë u luajt në palestrën e qytetit në Istog. Istogu vjet fitoi titullin e kampionit të Kosovës dhe Kupën e Kosovës. Tani ka në koleksion edhe trofeun e Superkupës. Istogu ishte

skudër dominuese dhe nisi herët shkëputjen. Albina Rugova ishte më efikasja me shtatë gola. Gjashtë i kishte Tainara Luna Goncalves, kurse nga katër i realizuan Dajana Milaniq dhe Tina Hetemi. Ivana Bojoviq i shënoi nëntë gola për Ferizajn. Albulena Kelmendi, Mirjeta Dinolli e Shkurte Mehmeti i kishin nga dy gola. Superkupa u organizua në kuadër të 15-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Ky aktivitet tani e tutje do të jetë tradicional.

## Sot tri ndeshje në Superligë, nesër dy

PRISHTINË, 17 SHKURT - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 20 e Superligës në futboll. Sot (e shtunë) zhvillohen tri ndeshje, kurse të dielën zhvillohen dy të tjera. Llapi, i cili e nisi me fitore edicionin pranveror, këtë radhë në stadiumin “Zahir Pajaziti” e pret skuadrën e Trepçës ’89, e cila në ndeshjen e parë të sezonit

pranveror e befasoi Dritën. Kjo e fundit kërkon këndellje. Në shtëpi e pret Dukagjinin e Klinës. Gjilanasit do t’i kërkojnë pikët e plota në mënyrë që të mos ngecin më shumë karshi liderit. Ata momentalisht janë të dytit me 38 pikë, tri më pak se kryesuesit. Në krahun tjetër klinasit janë të pestit me 25 pikë. Të shtunën përballen

edhe Ferizaj dhe Prishtina. Të dielën janë dy ndeshje të tjera. Skuadra kampione, Ballkani, kërkon fitore në shtëpi te Drenica dhe mbrojtjen e titullit kampion. Ndërsa kuqezinjët që pësuan humbje në javën e kaluar, tash kërkojnë të largohen nga pozita e tetë. Gjilani - Malisheva është sfida e fundit e javës së 20.




## Mick Schumacher: Kam oferta për t'u rikthyer në pistë

STUTTGART, 17 SHKURT - Këtë vit piloti i ri gjerman Mick Schumacher do të jetë rezervë te skuadra e Mercedesit. Një sezon që ai e konsideron si të përkohshëm, pasi synon të rikthehet vitin tjetër në Formula 1 si pilot titullar. Këtë gjë Mick

Schumacher e ka deklaruar disa herë si objektivin e tij, por ai ka treguar se ka marrë disa oferta. "Nuk është kjo ajo që unë dëshiroja të ndodhte këtë vit, që të isha rezervë, por ndoshta kjo është një botë tjetër që do të më ndihmojë t'i shoh gjërat

ndryshe e të përmirësohem si pilot. Jam në një pozicion komod, ku mund të mësoj shumë këtë sezon, edhe pse nuk ka shumë garanci për të ardhmen. Do të kem shanset e mia, pasi disa persona kanë shprehur që tani interesimin e tyre për mua. Diçka po

lëviz. Të shohim se çfarë do të ndodhë muajt në vijim, kur të nisim bisedimet. Kalendarit është i ngjeshur, por do të marr pjesë në ndonjë garë andej-këndej. Gjatë dimrit kam pilotuar një makinë të Formulës 3", ka thënë Schumacher.



## Kosovare Asllani viziton Kosovën

PRISHTINË, 17 SHKURT - Futbollistja me famë botërore, Kosovare Asllani, ka mbërritur për vizitë në Kosovë në kuadër të shënimit të 15-vjetorit të Pavarësisë. Ajo ka ardhur nën epitelin e Ambasadores së Shpresës së Mirë të UNICEF-it, teksa në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë është pritur nga presidenti Agim Ademi, bashkë me babanë e Kosovares, Naset Asllani. Duke i dëshiruar mirëseardhje në atdhe, Ademi i shprehu mirënjohjen e tij dhe të komunitetit të futbollit të Kosovës për prezantimin e saj dinjitoz të vendit të saj të origjinës kudo në botë përmes futbollit.

Kreu i FFK-së theksoi se vetëm emri i Kosovares ka bërë që të prezantohet vendi ynë në mënyrën më të mirë, derisa ka thënë se ajo është shndërruar në model për vajzat dhe gratë kosovare por jo vetëm, falë paraqitjeve të saj dinjitoze në fanellën e Real Madridit, Milanit dhe Kombëtares së Suedisë. Ademi, duke ia dhuruar figurën e 'Hyjneshës në Fron', theksoi se Kosovarja është një 'Hyjneshë Futbollit' dhe si e tillë është shembull për t'u ndjekur nga vajzat e reja kosovare. Po ashtu, Ademi e nderoi futbollisten me karrierë të bujshme



edhe me fanellën e Përfaqësueses së Kosovës, duke shprehur shpresën se pas përfundimit të karrierës ajo do t'i hyjë zëjës së trajneres dhe në të ardhmen kontributin e saj ta japë në rolin e përzgjedhëses së Kosovës.

Kosovare Asllani shprehu mirënjohjen e saj për kryetarin Ademi dhe FFK-në për mikpritjen e ngrohtë në këtë ditë të veçantë, duke i uruar atij dhe tërë popullit Ditën e Pavarësisë së Kosovës. "Ajo e përgëzoi FFK-në për punën e jashtëzakonshme dhe sukseset e

arritura pas anëtarësimit në UEFA e FIFA. Ajo theksoi se është shumë e lidhur me Kosovën dhe shprehu dëshirën që ndeshja përmblylëse e karrierës të jetë pikërisht ajo ndërmjet Kosovës dhe Suedisë, për çka kryetari Ademi i premtoi se kurdo që vjen ajo ditë, FFK-ja do të jetë e gatshme të organizojë një ndeshje të tillë. Gjithashtu, Kosovarja u shpreh e gatshme që në të ardhmen përvojën dhe kontributin e saj ta japë edhe si përzgjedhëse e Kosovës", thuhet në njoftimin e FFK-së.

## Milwaukee mposhti Chicagon, Clippersat i japin 'leksion' Pheonixit

CHICAGO, 17 SHKURT - Tri ndeshje të luajtura në NBA. Spikat fitorja e Milwaukee, që mundi me rezultat 112-100 Chicagon jashtë fushës. Ndeshje e dominuar nga Bucks, ku u dallua Brook Lopezi me 33 pikë. Lajmi i keq për Milwaukee është dëmtimi i Antetokounmpos, që la fushën pas 9 minutave lojë, për shkak të një dëmtimi në kyçin e dorës. Fitore disi surprizë arriti ekipi i Clippersave, që mundi me rezultat 116-107 Phoenixin. George dhe Mann realizuan nga 216 pikë secili për miqtë. Skuadra e Washingtonit triumfoi me rezultat 114-106 në shtëpinë e Minnesotas.



Bradley Beal realizoi 35 pikë për miqtë, duke i bërë të pavlefshme

34 pikët e Anthony Edwardsit për Minnesotan.

### REZULTATET

Chicago - Milwaukee	100-112
Minnesota - Washington	106-114
Phoenix - Clippers	107-116

### SHKURT

#### Dy klube interesohen Meritan Shabanin

Futbollisti nga Kosova, Meritan Shabanin, është duke u monitoruar nga dy ekipe evropiane. Për Shabanin, i cili është pjesë e klubit zviceran Grasshoppers, janë interesuar dy skuadra, Hellas Verona dhe Anderlecht. Mesfushori kosovar që ka refuzuar Kosovën ka pasur disa vjet të vështira në karrierë qysh prej largimit nga Bayern Muncheni. Ai ishte pjesë e skuadrës Wolves, por tani është transferuar në kampionati zviceran, ku ka zhvilluar 13 paraqitje deri tani. Shabani vlerën momentale në sajtin e njohur "Transfermarkt" e ka vetëm 300 mijë euro, shifër kjo që barazohet edhe me lojtarët e Superligës së Kosovës.

#### Lëndohet Pedri, mungon rreth pesë javë

Pedri ka pësuar një lëndim dhe do të jetë mungesë e madhe e Barcelonës. Ekzaminimet mjekësore kanë lënë të kuptohet se mesfushori i talentuar nuk do të jetë në dispozicion të katalonasve në pesë javët e ardhshme. Ai do të humbasë ndeshjet e rëndësishme ndaj Manchester Unitedit në Angli dhe në udhëtim ndaj Real Madridit në kuadër të Kupës së Mbretit. Pedri pësoi lëndim në ndeshjen ndaj Manchester Unitedit në Ligën e Evropës, me ç'rast u detyrua të largohej qysh në pjesën e parë.

#### Chelsea, gati ta blejë kartonin e Felixit

Presidenti i ri i Chelseas, Todd Boehly, është i kënaqur me afrimin e ri të merkatos së janarit, Joao Felix, i cili ka bërë mjaft mirë. Portugezi e ka gjetur menjëherë veten në futbollin e "ishullorëve", teksa është bërë pjesë e formacionit titullar që në mbërritjen e tij. Propozimi i bordit të Chelseas mund të jetë një shumë e caktuar parash, plus një ose më shumë lojtarë në një marrëveshje të mundshme. Atletico dëshiron të humbasë sa më pak para duke llogaritur këtu edhe 127 milionë eurot e shpenzuara për blerjen e Felixit nga Benfica. Gjithsesi bisedimet do të kryhen në fundin e sezonit, kur dhe "Blutë" e Londrës do të kenë një bilanc më të mirë nga paraqitjet e futbollistit portugez.

#### Allegri: Kualifikohemi në Francë dhe jo me fitore 1-0

Juventus dështoi në "Allianz Stadium", në takimin ndaj Nantes, i vlefshëm për Ligën e Evropës, pasi barazoi shifrat 1-1. Trajneri Massimiliano Allegri është shprehur i zhgënjyer me rezultatin e arritur, por është optimist se në Francë do të arrijë fitore me rezultat më të thellë se 1-0. "Na vjen keq sepse nuk e mendonim kështu fundin e kësaj sfide. Tani duhet të mendojmë për ndeshjen e kthimit, duhet të shkojmë në Francë për të luajtur për kualifikimin. Skuadra ime nuk do vetëm fitore 1-0. Mjaft me këto gjëra tani. Mos e teproni. Sulmi? Mund të bënim më mirë pranë zonës, rastet ishin, por tani duhet të përmirësohemi sepse nuk kemi kohë. Episodi VAR në fund? Me Fiorentinën ishte diçka objektive, sonte është një vendim që duhet pranuar. Një gjyqtar thirret në VAR për të gjykuar një penallti dhe më pas gjen një faull. Është e kotë të flasësh tani", ka thënë Allegri.

## Isco drejt rikthimit në La Liga


Isco ka mbetur futbollist i lirë që nga fundi i muajit dhjetor të vitit 2022. Mesfushori spanjoll vazhdon të mbetet i lirë përkundër se ka disa oferta, por që ende nuk ka vendosur të ardhmen e tij. 30-vjeçari është

në udhëkryq sa i përket të ardhmes së tij, pasi ka oferta nga Italia, Turqia, Anglia, Arabia Saudite dhe kampionati amerikan MLS. Por e përditshmja spanjolle AS ka raportuar se Isco mund të

rikthehet sërish në La Liga, ku Villarreali ka shprehur interesim për transferimin e tij. Drejtuesit e klubit spanjoll kanë hapur bisedime me agjentët e Iscos dhe gjatë ditëve të ardhshme pritet të ketë diçka

më konkrete për të ardhmen e spanjollit. Roma, Evertoni, Konyaspori, Los Angeles FC, Inter Miami, Al-Hilali dhe Al-Nassri janë skuadrat e tjera të interesuara për t'i marrë shërbimet e mesfushorit

spanjoll. Gjithsesi java e ardhshme pritet të jetë vendimtare për të ardhmen e Iscos, pasi lojtari u ka bërë të qartë agjentëve të vet se dëshiron sa më shpejt të bashkohet me ndonjë skuadër.



**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## LAJMËROJMË

Bashkëpronarit LATIF ( RUSTEM ) DESTASNI, RAMIZ ( SADIK ) MUSAJ DHE RESMIJE ( HETEM ) MUSAJ nga Fshat Zojz – Prizren, si Blerësit potencial se, Bashkëpronarët Dragisha Mitrovic, Sasha Mitrovic, Dragan Mitrovic, edhe Rajko Mitrovic, si bashkëpronarë ligjor të ngastrave kadastrale me numër P-71813028-00293, që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 20919 m<sup>2</sup>, Zonën Kadastrale Zojz-Prizren, po i Sheshim - pjesët tona bashkëpronësore.

Në këtë mënyrë i ofroj bashkëpronarëve, poqë se janë të interesuar për blerje, të më lajmërohen në afat prej 30 ditëve, në adresë: rr. " Fehmi Lladrovci " nr.70 – Prizren.

Një herri informoj se, e kam Blerësin potencial i cili brenda afatit prej 30 ditëve do ta paguan çmimin e përgjithshëm prej 5.000 €, me para të gatshme-në kesh.

Telefoni kontaktues: +383 (0) 44/351-471

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Sabina Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimanzit "Hajdar Dushi".

- Mana Pervorfi Novosell e Ulët, shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. "Engjull Jak Gjoni" Novosell e Ulët kk Gjakovë nga kl. I-VIII.

- All Star Sport Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit më nr. 811847394.

- Luljeta Qoqaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Lekë Dukagjini" Prizren.

- Ardit Gashi shpall të pavlefshme certifikatën shmlt "11 Marsi" Prizren

- Onda Bilard&Bar SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811348631.

- Jonida Lulzim Haxhiajdini nga Peja shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të edukimit pran universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me nr. 408

- Liki&Abi SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811477589.

- Shahin Arifi shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT : Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).

- Blerta Gjeloshi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni "

- Lutfi Hajra shpall të pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani " ( ish Boris Kidric).

- Xhevdet Brahimi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Jusuf Rexha".

- Mentor Bunjkau B.I shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb:81036429.

- Famous Club sh.p.k shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810110114.

- Arbnor Rexhepi shpalle të pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e maturës te SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Berat Bajraktari shpalle të pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Shefki Azemi shpalle të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga DTC me numër 366/18 Kursi Hidroinstalim-ujësjellës.

- Rafet Durmishi shpalle të pavlefshme diplomën e SHMLT" Arkitekt Sinani".

- Naser Hasani B.I shpalle të pavlefshme certifikatën e TVSH-se e numër 330043737.

- Mentor Rexhepi shpalle të pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e SHMLM" Dr Xheladin Deda".

- Antigone Beka shpalle të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës se mesme " Dr. Xheladin Deda".

- Vëllezërit Hysa SH.P.K. Dega Kosove shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811324409.

- Sh.P.K Broja Market shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810359209.

- Eskont L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 810140335.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

